



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 11, datë 24.12.2024

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 24.12.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare ! Të nderuar pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin Dhjetor të Këshillit Bashkiak Durrës.

Kjo mbledhje plenare e Këshillit konsiderohet një ndër mbledhjet më të rëndësishme të vitit, pasi do të shqyrtojmë buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2025-2027 si dhe projektvendime të tjera të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Do të informohemi dhe se si ka shkuar mbarëvajtja e turizmit në Durrës gjatë këtij viti. Ftoj sekretaren të bëj prezencën .

Dorina Milja: Përshëndetje!

Fillojmë me prezencën.

Ardian Muka.....deri tek.... Florian Tahiri.....

39 Këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Atëherë faleminderit.

Vazhdojmë me mbledhjen meqë korumi është i pranishëm.

Kemi sot për shqyrtim e miratim 9 pika. Po prezantoj pikat një e nga një si më poshtë:

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN DHJETOR 2024
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2025
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM (PBA) PËR VITET 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2025 DHE PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.157, DATË 18.10.2023, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO ROMANOS - KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË”, I NDRYSHUAR

Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.592, DATË 11.03.2019 “PËR MIRATIMIN E EMËRIMIT TË DREJTORIT TË QENDRËS KULTURORE “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TRANSFERTAVE TË PAKUSHTËZUARA DHE SEKTORIALE SHITESË TË ALOKUARA NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR. 5, DATË 19.12.2024 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.97/2023 “PËR BUXHETIN E VITIT 2024”, TË NDRYSHUAR
Pika 9. Informim i këshilltarëve	RAPORTIM LIDHUR ME SEZONIN TURISTIK PËR VITIN 2024 NË DURRËS

Ani Dyrmishi: Kemi ndonjë diskutim përsa i përket rendit të ditës?
Atëherë diskutim nuk ka kalojmë në votim.

Dorina Milja : Po është votim elektronik.

Ani Dyrmishi: Ka ngelur dikush pa votuar?
Atëherë mbyllet votimi.

39 pro, asnjë kundër miratohet rendi ditës.

- Kalojmë në **pikën e 1-rë**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, z. Tahiri.

Rolant Xhelilaj : Kryetar !

Ani Dyrmishi: Për procedurë?

Rolant Xhelilaj : Po.

Duke pasur parasysh atë që theksuat ju në fillim të mbledhjes, që sot konsiderohet një mbledhje e rëndësisë së veçantë për faktin se miratojmë projektbuxhetin e vitit 2025 të bashkisë dhe projektbuxhetin afatmesëm edhe në kushtet që janë 9 pika, propozoj që të kalojmë të gjithë pikat e tjera dhe dy pikat taksat dhe buxhetin t’i lëm për në fund.

Ani Dyrmishi: Atëherë mbas propozimit tuaj ta hedhim në votim.

Kush është dakort për propozimin e zotit Xhelili?

Hapim votimin elektronik.

Atëherë kush nuk ka votuar akoma?

1 pa votuar, 38 pro kalon propozimi i zotit Xhelilaj. Pika 2 dhe 4 kalon në fund.

- Vazhdojmë me pikën 1. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, z. Tahiri.

Florian Tahiri: Atëhere si gjithmonë Komisioni u mbledh dhe nuk ka aplsolutisht asnjë gjë për tu shqyrtuar, sepse jemi gjithmonë Pro për kalimin dhe miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar. Komisioni është okej (okay).

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1?

Atëhere kalojmë me karton.

39 pro, asnjë apstenim, asnjë kundër miratohet pika 1.

- Kalojmë **në pikën 3** meqë pikën 2 e kemi kaluar në fund. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Xhelilaj

Rolant Xhelilaj: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës u mbledh vetëm me pjesëmarrjen e anëtarëve nga grupi i Partisë Socialiste edhe e miraton. E kalon në mbledhje për votim.

Ani Dyrmishi: Ju faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 3 kemi?

Nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet pika 3.

- Kalojmë me **pikën 5**, meqë pika 4 e kaluam në fund. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit zonjës Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi: Përshëndetje!

Dhe komisioni ynë u mbledh dhe ra dakort që kjo pikë të kalojë sot në votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 5 kemi?

Nuk ka kalojmë në votim.

Kush është Pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës ?

Kundra?.....

Abstenim?.....Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet.

- Kalojmë **në pikën 6**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, përshëndetje Kryetar, të gjithëve!

Atëhere komisioni jonë u mbledh dhe kalon për votim sot pikën 6. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje!

Edhe komisioni jonë pas sqarimit nga përfaqësuesit e bashkisë me detaje në lidhje me këtë pikë ranë dakord ta kalojmë për miratim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zoti Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit .

Edhe Komisioni i Pronave Publike e kaloi në unimanitet për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 6?

Po, zoti Muka.

Ardian Muka: Mirëdita të gjithëve!

Një koment kam, meqenëse për vlerën e shpronësimit që u jepet banorëve të zonës diskutohet për 544 lekë, do thoja të shihet mundësia që kjo zonë sikurse bëme edhe pjesën tjetër të qytetit duke qenë se është brenda vijës së verdhë zonës së qytetit, të shihet edhe kjo me çmimet e tregut. Natyrisht ne jemi në moment që është pothuajse hapi përfundimtar, pra aprovimi, por besoj që është e moralshme dhe e drejtë që edhe për këto zona, pra edhe për zonën ku ky projekt për reabilitimin e infrastrukturës rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos, por edhe në atë çfarë do të jetë në zhvillim të nesërmen në zonën e Protit të Ri që diskutohet atje, të shifen në këtë optikë, pra të meren për bazë çmimet e referencës të tre muajve të fundit të operacioneve të shkëmbimit që janë bërë nga privatët. Pra në bashkëpunim me ASHK-në të shihet mundësia që të trajtohen kështu. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6?

Kundra?.....

Abstenim?.....Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet pika 6.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 7**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Musaraj.

Joniada Musaraj: Ndjesë Kryetar, se kisha mendjen dhe një herë, për pikën?

Ani Dyrmishi: Pikën 7.

Joniada Musaraj: Atëhere për pikën 7, Komisioni ynë u mblodh dhe me dy, me shumicën e votave e kalon sot për votim,

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Joniada Musaraj: Kishim vetëm një vote kundër. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zonja Luarasi.

Denisa Luarasi: Edhe për këtë pikë, Komisioni ynë ra dakort.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 7, kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstemin?.....S' ka.

Atëhere me 39 vota pro miratohet.

- Kalojmë më projektvendimin **për pikën 8**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave dhe Tarifave, zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe për pikën 8 Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit është dakort që ky ndryshim në buxhetin e vitit 2024 për “Tranfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale” që kalojnë në favor të bashkisë së Durrësit, të miratohen, të kalojnë në mbledhje.

Ani Dymishi: Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 8?

Dritan Burgija: Po.

Ani Dyrmishi: Po zoti Burgija.

Dritan Burgija: Përsa i përket këtyre dy pikave të fundit siç e kam shpreh dhe tek grupet e komunikimit nuk biem dakort t'i shtohen pikat të rendit të ditës ditën e fundit. Në një mbledhje si kjo që miratohet buxheti dhe materiali ishte voluminoz nuk mund të na shtohen dy pika të rendit

të ditës, qoftë kjo dhe të parëndësishme siç i konsideroni, unë i kam kundërshtuar aty dhe do t'i votojmë kundra këtui, vetëm për këtë shkak.

Emiriana Sako: Por është për çështje...

Dritan Burgija: Urdhëro?

Emiriana Sako: Është për çështje procedure kjo. Pra nëse janë transferuar fondet me akt nomativ duhet të kalojnë në këshill që të bëhen vizibël.

Dritan Burgija: Por jo më pak se 24 orë përpara.

Emiriana Sako: Eshtë thjesht për procedurë, thjesht për procedurë, megjithatë ke të drejtën tënde ta votosh siç e mendon.

Dritan Burgija: Por për procedurë po them dhe unë, ne kemi nevojë që ta lexojmë materialin, kemi nevojë të merremi me këtë punë domethënë një ditë përpara, se u kthye si rregull, u bë e përhershme kjo punë. Domethënë që miratojmë një rend dite, mbledhemi miratojmë rendin e ditës dhe pastaj na shtohen në momentin e fundit na shtohen pikat e rendit të ditës që këshilltarët ndoshta s'kanë mundësi të merren me materialin. Vetëm për këtë shkak për pamundësi për tu marrë për të shqyrtuar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Ok, faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?.....

Atëhere 30 pro, 9 kundra, asnjë abstenim. Atëhere miratohet edhe pika 8 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 9-të**. I japim fjalën për një "Raportim për sezonin turistik" zonjës Floreta Kërtusha.

Floreta Kërtusha : E nderuar zonja Kryetare e bashkisë !

I nderuar zoti Kryetar i Këshillit Bashkiak !

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak!

Raportimi është pak i gjatë unë do mundohem ta paraqes shkurtimisht dhe ato që janë më të vlefshme sot dhe për çdo të dhënë tjetër shtesë apo informacion që ju duhet apo është i nevojshëm për ju, jemi të gatshëm që në çdo moment t'jua vëmë në dispozicion.

.....Përmbledh raportin e dorëzuar pranë Sekretarisë së Këshillit me shkresë me nr.prot 13046/1, datë 19.12.2024.....

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment në lidhje me....?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Kisha një pyetje pastaj kam dhe komentin. Në material ju referoni që sipas të dhënave nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ardhurat e fituara nga taksa e fjetjes për periudhën janar-nëntor janë në vlerën 140 229 641, pra rreth, atëhere me të vjetra 1 miliard e katërqind milion, po themi rreth 1,4 milion euro, kjo vlerë është e certifikuar pra nga Drejtoria e Taksave Vendore...Po?

Floreta Kërtusha: E sjellë zyrtarisht, po.

Ardian Muka: Pra, deri në nëntor flasim?

Floreta Kërtusha: Po.

Ardian Muka: Mirë, faleminderit

Ani Dyrmishi: Atëhere?

Ardian Muka: Atëhere duke pasur parasysh që turizmi është një nga pilastrat e ekonomisë qytetase, në ato çfarë na referuan nuk i heq asnjë presje, punë është bërë, por besoj dhe uroj që për 2025 të jemi në të tjera ritme dhe në atë se çfarë pretendohet pra diskutohet që këtë vit në Durrës kanë ardhur rreth një milion e gjys duke pasur parasysh atë që zoti kryeministër tha që pritshmëri rreth 15 milion 17 milion këtë vit, vitin tjetër uroj që të jenë më shumë.

Megjithatë unë vi, nga profesioni jam inxhinier kështu që shof pak numrat dhe në numra që referohen më dalin edhe shifra kontraktore. Atëhere unë kam parë një raport ndërmjet 2023 dhe 2024, numri i hoteleve është rritur gjithmonë në atë që na është referuar nga raporti i vjetshëm përse i takon turizmit, 168 në 2023, 229 në 24, dhoma kemi 4 859 në 2023, 6 653 për 2024, numri i shtetërve është rritur me rreth 3000 shtetër, nga 11 528 në 2023, 14 853 në 2024. Të ardhurat, në 2023 kemi 567 milion lekë ndërkohë që për 2024 të deklaruar pra janë 1 miliard e 400 milion lekë ose 1.4 milion euro, kundrejt 567 mijë që ishin vitin tjetër, pra kemi një rritje prej 147% .

Unë kam bërë një mesatare, po i them të gjitha këto për të arritur pastaj në çfarë do të nxjerr si konkluzion natyrisht përgjigja ju takon juve. Një mesatare e taksës për natë duke pasur parasysh që Durrësi ka struktura Hoteliere 4-5 yje, ka në zonën A dhe zonën B, sikurse ka struktura të tjera siç janë bujtinat, dhomat pra shtëpitë e pritjeve po themi, duke pasur parasysh që tarifat janë 350 lekë, 105 lekë, 140 lekë dhe 35 lekë kam bërë një mesatare ndërmjet të gjithë këtyre dhe arrij në 158 lekë për natë, mesatarja pra, e qëndrimit për të gjitha strukturat meqenëse neve nuk kemi të përcaktuar sa janë struktura 3, 4 dhe 5 yje dhe sa janë strukturat e tjera që të bënim një analizë më të detajuar. Përse i takon pra turistëve që kamë qëndruar në qytet është 1 milion në 2023 dhe 1.5 milion të deklaruar për 2024 për 11 muaj. Atëhere gjithmonë sipas raportit të bashkisë për 2024 kemi 14 853 shtetër për 90 ditë, pra ato kanë bërë një mesatare për 3 muaj duke llogaritur maksimumin e turistëve për 90 ditë, pra për 3 muaj për numrin e shtetërve janë 1 336 770 netë,

pra kjo është mundësia aktuale e pritjes në qytetin tonë. INSTAT për 2023, se për 2024 nuk ka dalë, llogarit 3.5 net qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, pra të huajt që vijnë mesatarisht kanë ndenjtur 3.5 net me tendencë rritje gjatë INSTAT-it. Atëhere ajo që unë do thoja shtë që duke llogarit që neve llogarit i bëjmë për 90 ditë kemi 24.6% koficientin e shfytëzimit të strukturës vjetore. Natyrisht nuk është reale, sepse kohëzgjatja besoj që në Durrës është më e gjatë për momentin të gjithë neve jemi koshient për këtë pjesë, por edhe duke llogaritur për kaq periudhë sa ju thoni, besoj që kjo nuk është nga ana ekonomike përfituese pra me 25 % nuk ka ndërrmarrje, 25% pra të shfrytëzoj të kapaciteteve të veta dhe të arrij të dali një ndërrmarrje me fitim në fund të vitit. Që këtu ka diçka që nuk qëndron, dhe ajo që nuk qëndron është prap tek numrat, 1.5 milion turist që neve pretendojmë që kanë ardhur për 3.5 ditë qëndrimi që deklaroi INSTAT-i për 1.6 euro, pra 158 lekë që llogaritem për natë mesatare, inkasimi duhet të ishte 8.4 milion euro dhe jo 1.4 milion euro që neve kemi deklaruar. Ndërkohë nëqoftëse bëjmë një analizë mbrapsht kemi 1.4 milion euro pra që deklarojnë të ardhura pjesëtuar për 1.6 euro apo 158 lekë pra për natë qëndrimi mesataren, pjesëtuar për 3.5 ditë i bjen që kanë sorxhorniuar ë Durrës 250 mijë turist, pra duhet të zgjedhim dhe të marrim, ose kemi një informalitet galopant ku realisht kemi inkasuar 1.4 milion ku ndërkohë duhet të kishim 8.4 në kasë ose numri i turistëve nuk është real, pra deklarojmë 1.5 milion turist ndërkohë që sipas të dhënave dalin 250 mijë.

Ka dhe një difekt, por këtë do ta diskutojmë tek pjesa e buxhetit. Atë që unë do të thoja është që puna e bashkisë përsa i takon kësaj pjese, pra pjesës së të ardhurave çalon, çalon si në mënyrën se si na e kanë prezantuar, por nuk hedh hije dyshimi, nuk hedh hije dyshimi në numrat që ju deklaroni, por të vërtetat janë këto. Kush ma hedh poshtë matematikën bujrum le të komentojë.

Atëhere tjetër që do të thoja është që në mendimin tim përsa i takon pjesës së buxhetit, buxheti për turizmin duhet të ishte më i madh dhe e them këtë që Drejtoria që merret me turizmin duhet të ketë një sektor të veçantë që nuk duhet të lejë panair, nuk duhet të lejë mundësi përfaqësimi të qytetit tonë pa u prezantuar, ku të ketë neve duhet të jemi prezent, e them këtë sepse realisht shohim që në Shqipëri ne jemi në një moment bumi, por uroj të mos jetë si ky bumi këtu, pra që numrat nuk korrespondojnë, por gjithsesi neve duhet të bëjmë punën tonë dhe puna jonë është që produktin që kemi, kemi një qytet të vjetër me arkeologji, kemi një qytet që zoti i ka fal diellin, i ka fal rërën, ujin, duhet ta valorizojmë më mirë mos të presim që këtë punë ta bëj Tirana, ta bëj kryeministri, ai vazhdon ka linjën e vet vazhdon për Dhërmiun, Sarandën, pjesën e jugut, ndërkohë që për Durrësin sa herë që flitet për pjesën e turizmit del vetëm Amfiteatri.

Insistoj për këtë pjesë, që si për buxhetin që po, do kalojmë, të merret parasysh pra, që pjesa e turizmit për qytetin tonë të ketë një fetë më të madhe përsa i përket pjesës së investimit. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Zoti Markola, pastaj Musaraj.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Atëhere përsa i përket shifrave po i përgjigjem zotit Muka që rritja është 300 % jo 140 %, nëqoftëse ishin 500 milion të ardhura vitin që kaloi 1 miliard e gjys është trefishi, që këtu e filloi

gabim analizën që bëri, teorikisht ka të drejtë, por mos të harrojmë që turist quhet saktësisht një person që lëviz nga një vend në një vend tjetër dhe qëndron më shumë se 24 orë e para.

E dyta turizmi në vete është një shkencë që ka disa lloj rrymsah, përshembull turizmi rërë - diell që ka ngatërruar Xhaferri me turizmin e diellit, turizmi religjioz, turizmi kulturor, por kemi dhe një rrymë që quhet turizmi transport. Mos harrojmë që Durrësi është një qytet port, që ka një port shumë të rëndësishëm dhe turizmi, rryma e turizmit transport është që jep në impakt shumë të rëndësishëm që edhe mund të mos regjistrohet siç e mendon ai tek fjetjet, tek taksa e fjetjeve Normalisht ka një informalitet këtu kuptohet, por mos të harrojmë që kemi dhe dhomat që jepen me qera, të cilat nuk janë të deklaruar dhe nuk ka dhe se si të maten nga institucionet përkatëse. Prandaj unë mendoj që është bërë një punë shumë e mirë, një rritje 300% e të ardhurave për 1 vit nëqoftëse do të vazhdojmë me këtë ritëm shumë shpejt do të shkojmë aty ku do dhe zoti Muka, faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Zonja Musaraj.

Ardian Muka : Mundem?

Joniada Musaraj: Prit 2 sekonda, që ti bësh paket ndoshta të dyve bashkë.

Atëhere vetëm një diçka zoti Muka doja të ju thoja që gjithmonë kemi respektuar analizën që ju bëni rrjedhën llogjike në fakt jo thelbin dhe sot shikoj që vini me një analizë ndoshta nga lodhja që keni patur dje, s'ke patur kohë dhe e kuptoj shumë mirë, patët përplasje në shifrat që ju përmëndët nuk lidheshin me njëra tjetrën. Dhe të ju themi diçka në lidhje me buxhetin nëse ka një gjë që sot e votoj me krenari këtë buxhet është karakteri social që ka buxheti dhe që nuk e ka humbur nga viti në vit. Ju përmendni turizmin dhe nëse do e kishit patur kohën e duhur për të analizuar buxhetin ashtu siç duhet dhe raportin mbi turizmin nuk do vinit sot të thonit ato që ju thatë. Kjo vjen nga pjesa e informacionit dhe jam e bindur për këtë. Dhe në lidhje me analizën që ju bëni të shifrave i besoj më shumë një strukturë të plotë që ka bashkia të gjitha drejtorive që bëjnë një punë kolosale pastaj sjellin produktin, sesa ti besoj një anëtarë këshilli që kurdoherë dhe gjithmonë më përmend moralin dhe në fakt nuk më sjell kurrë një instrument efektiv sesi të ndryshoj situata apo gjëja që ju pretendoni që nuk shkon. Shumë faleminderit.

Ani Dyrmishi: Zoti Muka 2 minuta.

Ardian Muka: Besoj se do ta mbaroj edhe më shpejt.

Me zotin Markola i referohem atë çfarë është shkruajtur në raport, pra thuhet në faqen 4, kështu sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifës Vendore të ardhurat e arkëtuara nga taksa e fjetjes për periudhën janar - nëntor 2024 në vlerën 140 milion 229 641 ose 147 % më shumë, ku e gjen 300% e din zoti Markola pastaj... Në krahasim me vitin 2023 që është 56 ka qenë 47, thashë i referohem raportit nuk bëra unë komente të mijat.

Përsa i takon komentit tjetër që bëri zonja Musaraj me thënë të drejtën, po dje kam qenë paqef kam qenë i pamundur dhe kam pas mundësinë të rri në shtëpi dhe kisha kohë për tu marrë dhe me numrat. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Atëhere komente të tjera nuk ka, kalojmë.....

Po znj.Ngota.

Zhuljeta Ngota:Atëhere unë nuk jam eksperte që të flas me shifra ua lej ekspertëve këtë, por në lidhje me turzimin do të doja që të kishte një plan për qentë e rrugës, sepse unë si punonjëse e spitalit rajonal kam parë plot turist që kanë ardhur nga kafshimi i qenve dhe këto janë numra me dhjetra, kështu që do ishte mirë të planifikohej një diçka, jo të vriten, sepse kemi parë nga këto që vrasin qentë, por të sigurojnë një streh të bëhet një gjë pak më njerëzore për këto 4 putrorshat. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: E kemi marrë një vendim duhet të jesh në dijeni se je pjesë e këshillit, por gjithsesi.

Zhuljeta Ngota: Nuk... meqenëse po i shohim çdo ditë.

Ani Dyrmishi: Jo e kemi marrë një vendim që e ke votuar edhe ti, por si duket nuk e mban mend

Zhuljeta Ngota: Po po, ndoshta kam qenë në mungesë, po për 2025 të jetë pak më...

Ani Dyrmishi: Duhet të jenë në proces tashmë.

Zhuljeta Ngota: Ok

Ani Dyrmishi:Faleminderit.

Atëhere koment tjetër, nuk ka.

- Kalojmë te **pika 2**. I japim fjalën zotit Xhelilaj. Komisioni i Buxhetit Financës Taksës dhe Tarifës.

Rolant Xhelilaj: Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit kaloi projektvendimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit me votën e të gjithë anëtarëve që morën pjesë, Partisë Socialiste dhe Partisë Agrare Ambientaliste.

Ani Dyrmishi: Faleinderit.

Atëhere komente për pikën 2 ?

Po, zoti Muka.

Ardian Muka: Atëhere përse i pëket sistemit të taksave dhe tarifave vendore të qytetit të Durrësit për 2025 unë kam disa detaje teknike, nuk jam ekonomist, kështu që me ato çfarë kam arritur të shoh.

Atëhere në faqen 4, përse i takon taksës mbi truallin, flitet se taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, dokumnetacioni që përdoret për caktimin e bazës së taksës është certifikata e pronësisë, vërtetimi hipotekor, dokumenti i vlerësimit nga aluizmi, vendimi i komisionit të vlerësimit të pronave i shoqëruar me vlerësimet reale. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë ndërtesë, tokë bujqësore ose truall, përdoruesi i ndërtesës bën vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa e firmosur vulosur nga ekspert të licensuar. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme. Nuk më duket normale që në 2025 neve të kemi akoma këtë lloj informaliteti, pra të ngelim në dorë të vetëdeklarimit të banorit apo të biznesit, ndërkohë që pyetja ime është : Sa % e kësaj takse mbledhet nëpërmjet këtij sistemi? Pra atyre që nuk kanë një dokument pronësie të rregullt, por bëhet me vetëdeklarim dhe pjesën tjetër, me certifikim që i bën bashkia, kjo vlen si për taksën e truallit, si për taksën e ndërtesave dhe për taksën e tokës bujqësore.

Ke “taksa mbi ndërtesën” tek përjashtimet nga taksa për ndërtesën kemi pikën “e”, strukturat akomoduese “Hotel/Resort me 4 dhe 5 yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”; këtu besoj se duhet saktësuar për sa kohë përjashtohet, sepse këto nuk përjashtohen për të gjithë periudhën që do të ekzistojnë këto struktura. Në certifikimin që ato marini shprehet qartë që për një periudhë 3 vjeçare, 5 vjeçare apo 10 vjeçare bëhet ky përjashtim, prandaj dhe në këtë rast sugjeroj që këtu duhet të saktësohet si pjesë e dokumnetacionit.

Dhe një koment që kam për mënyrën sesi bëhet vjelja e taksës. Si për familjarët ashtu edhe për bizneset kemi dy komponente pra është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është dhe Drejtoria e Shërbimeve, do sugjeroja që Drejtoria e Shërbimeve dhe për aq strukturë sa ata kanë në nivel specialistësh që për mendimin tim nuk është që janë në numrin e duhur ndofta ky sektor duhet përforcuar, pasi ta bëjë pjesën e vet të llogaritjeve duhet t’ja kalojë Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore. Pra në fund fare qytetari duhet të ketë të bëjë me një sportel, mos ti vi një tarifë nga Drejtoria e Shërbimeve dhe tarifa tjetër ti vi nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, komunikimi të kryhet nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, meqenëse ky është institucioni, kjo është Drejtoria përgjegjëse që në fund fare merret me këto procedura.

Përse i takon “taksës së fjetjes në hotele” do doja një informacion: Që për momentin si bëhet kontrolli i hoteleve apo e njëjseve akomoduese nga ana e bashkisë për numrin e netëve të qëndrimit? Pra, kjo është me vetëdeklarim? Kalon nëpërmjet Drejtorisë së Taksave Qendrore dhe i referohet bashkisë apo ka bashkia instrumentet e saj të kontrollit? Këtu besoj që shembujt që neve kemi në vendet rreth nesh duke futur Malin e Zi, Kroacia, kemi shembuj shumë të mirë ku të gjithë ne besoj kemi shkuar, kemi kaluar ndonjë periudhë turizmi në këto vende atje vetëdeklarohet, pra pronari merr pashaportat plotëson dokumentat dhe shkon i dorëzon pranë Bashkisë apo Policisë Bashkiake që ato kanë dhe ky është mjet komplet deklarimi është dhe mjet kontrolli nga ana e tyre. Këtu te ne thashë nuk është që jam i sektorit, do doja një informacion për këtë pjesë.

Ani Dyrmishi: Ke prap...

Ardian Muka: Tarifën e zënies së hapsirave publike...

Ani Dyrmishi: Shtype dhe një herë z. Muka të lutem edhe një here se e fika.

Ardian Muka: Për “tarifën e zënies së hapsirës publike”, është i njëjti problem, pra janë dy drejtori që ndërhyjnë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave Vendore, do preferoja, për të mos krijuar konfuzion te qytetarët që të ishte një sektor, pra të ishte Drejtoria e Taksave. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Zoti Myshketa.

Jonuz Myshketa: Përshëndetje të gjithëve!

Në radhë të parë po ti shikojmë të gjitha dokumentat si raportin dhe buxhetin dhe pjesën e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, në letër janë të gjitha për tu përgëzuar.

Do ndalem tek pjesa e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, që përbëjnë burimin kryesorë të ardhurave të Bashkisë Durrës. Unë nuk bie dakort, sepse jemi dhe në proces gjyqësor me Bashkinë Durrës në lidhje me tarifimin e parkimit me pagesë përpara se të merreshin disa masa alternative siç ishte që të zgjidhej transporti rrugor e të tjerë, të cilat japin dhe ndihmesë gjatë dhe gjatë sezonit turistik, pjesa e një menaxhimi të transportit urban dhe interurban më eficient, i kemi bërë, i kemi parashtruar dhe gjatë mbledhjes, mbledhjes të ardhshme, të shkuara ndjesë.

Unë do doja në lidhje me sistemin e taksave dhe tarifave vendore duke iu referuar dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit ka një mungesë të madhe të të ardhurash nga bashkia dhe nuk ka dhe një rezymë në lidhje me borxhet që kanë bizneset kundrejt Bashkisë Durrës në lidhje me taksat e mospaguara dhe janë evidentuar dhe përmes sistemit të taksave të bashkisë ku ka biznese që vazhdojnë dhe punojnë të qeta duke pasur detyrime multivjeçare mbi kurriz, e cila krijon një mungesë të ardhurash të bashkisë dhe detyrimsht dhe rrjedhimisht dhe mungesë investimesh dhe përktimesh shërbimesh të munguara, por gjithashtu krijon dhe avantazh përmes paligjshmërisë krahasues dhe konkurues kundrejt atyre që i kanë paguar këto taksat dhe tarifatat vendore.

Do doja a kemi një informacion në lidhje me të gjitha detyrimet që kanë mbi trembëdhjetë mijë e sa biznese dhe qoftë dhe të mbartura të Bashkisë Durrës, të cilat do të ishte një ndihmesë shumë e madhe për të gjithë punët dhe sfidat që ka Bashkia Durrës për të bërë.

Dhe shpreh votën, abstenojmë këtë pikë për arsye se kjo nuk votohet veçmas, por votohet në tërësi për atë çfarë shpreha më lart dhe një nga pikat kryesore është pjesa e tarifimit të parkimeve me pagesë pa u marrë masat alternative dhe presim dhe si do shkojë vendimi gjyqësor në lidhje me këtë pikë. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Zoti Konesha.

Munir Konesha: Unë nisem në atë që tha zoti Muka, për sistemin e vetëdeklarimit, unë meqenëse punoj në këtë sektor kur të arrijmë ne që të jemi në sistemin e vetëdeklarimit do të jetë një sukses shumë i madh, por tani ne e kemi krejt ndryshe në taksat vendore dhe taksat lokale, por sistemin qendror e kemi me vetëdeklarim.

Por meqenëse mora dhe fjalën dua ta përgëzoj administratën lokale tatimore edhe në 2023 arkëtoi shuma më shumë sesa në 2022, besoj dhe në 2024 më shumë sesa në 2023, dhe për këtë përfitoj nga rasti ti kërkoj edhe kryetares së bashkisë ta mbështes këtë administratë, në infrastrukturë, në personel, në teknologji, pasi do të kthehen shumë shpejt këto investime. Këto kisha unë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zoti Konesha.
Zoti Markola

Hekuran Markola: Faleminderit.

Unë kam një propozim për vitin tjetër ndoshta që të krijohet Komisioni i Apelimit të Ankesave besoj se ka ardhur momenti që bashkia e Durrësit ta ketë një komision të tillë, jo në një formë tjetër që të jetë një komision i veçantë, jo duke ju drejtuar kryetares së bashkisë apo ku di unë... Kështu që mendoj të merret

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Atëhere koment tjetër?

Nuk ka kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?.....1,2,3,.....10

Dorina Milja : Ka ikur Bledari.

Ani Dyrmishi: Atëherë 28 pro, 10 abstenim, miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 4.** I japim fjalën Komisionit të Buxhetit Taksave dhe Tarifave zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Komisioni i Buxhetit e miraton projekt-buxhetin dhe e kalon në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për miratim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4?

Zoti Muka.

Ardian Muka: Dikush duhet ta bëjë oponencën apo jo?

Ani Dyrmishi: Kemi për të ndërruar zërin kemi për të vënë një zë tjetër

(...qeshje në sallë....).

Flutura Kasa: Kryetar dhe një pyetje kisha nëse ma lejon?

Ani Dyrmishi: Ja lejon zoti Muka?

Ardian Muka: Po patjetër, me kënaqësi.

Flutura Kasa: E lejon ai, e lejon , se e di që kam respekt për të. Vetëm kisha diçka, të lutem shumë sa më konciz, se sinqerisht edhe pak mua më zen gjumi, megjithëse s'kam qenë mbrëmë me ju, po pa gjum po ta them me pastërti sa më konciz të lutem.

Dritan Burgija : Mesa duket ajo mbrëmë ju paska djeg ëëë.

Flutura Kasa: Mu s'më djeg asigjo, të jesh i sigurtë.

E ka bo si shpreje të djeg, të djeg.

S'më djeg asigjo mu.

(Shumë zhurmë, flasin të gjithë përnjëherë.....)

Ani Dyrmishi: O Flutura, të lutem.

Zoti Muka, mund të vazhdosh me fjalën.

Ardian Muka: Nejse besoj që në ato fjalët e mia kam qenë konçiz nuk kam dalë jashtë kohës.

Ani Dyrmishi: E mirë plotësoja dëshirën dhe këtë radhë znj.Kola, Znj. Kasa.

Ardian Muka: Kolegët më japin dhe nga koha e tyre, rëndësi ka që, e rëndësishmë është që të dalin problemet.

Atëhere në relacioni e buxhetit të vitit 2025 në programin buxhetor afatmesëm 25 -27 në faqen 15 të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel. Në deklarimin që ju bëni normal është baza e takës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndrimit në hotel për person, në faturën shënohet çmimi i fjetjes, në deklarimin që lloji i të ardhurave në 2023 është 65 milion e 391, në 2024, 65 milion 000, ndërkohë që në raportin që sapo dëgjuam nga turizmi deklarohet që vlera është 140 229 641 lekë, pra ka një diskrepancë rreth 80 milion lekë të reja.

Më fal lloji i të ardhurave taksa vendore të shërbimit hotelier.....

Atëhere unë shoh që ka një diskrepancë, pastaj specialistët të na e thonë. Në bashkinë Durrës operojnë afersisht 205 hotele ndërkohë na referohen 229 në raport, me një kapacitet 5853 dhoma, ndërkohë që na referohen 6653 dhe numër shtretërish 13533 në këtë në raportin e buxhetit, në raportin që sapo dëgjuar 14853. Tani kush e ka problemin? E ka kjo? Se mirë kjo qenka pjesa që nuk arrijmë ne. Dhe ky është plani dhe ky është realizimi dhe fakti që këtu raportohet 140 milion

pra 1 miliard e 400 të vjetra, për thjeshtësi me njerëzit, është deri në nëntor dhe kjo nuk është e mbyllur. 65 milion nuk flitet për plan, të ardhurat nga kjo taksë planifikohen të rriten me 69% për 2025, 2024 është 65 milion.

Hekuran Markola: Nuk është mbyllur 2024, kjo është plani i 2024.
23 është mbyllur.

Ardian Muka: Faqja 16, përsa i takon kontributit në sektorin privat për krijimin e fondit publik banesave sociale për kalimin e sipërfaqeve ndërtimore është dhënë vlerë leku në bazë të së cilës është bërë dhe planifikimi në vlera monetare. Do doja një informacion? Se neve po pyesim, por asnjëri nuk po na jep përgjigje .

Joniada Musaraj: Sepse kalove nga hoteleria në
Ku është pyetja?

Ardian Muka: Tashi do t'i merrni një nga një? Ose ndryshe kush mund të më japi përgjigje ose ndryshe ti bëj unë të gjitha pyetjet pastaj jepni përgjigje.

Roni Shqiopa (Drejtore i DTTVendore): Po të flas do dalësh keq në sy të të gjithëve.

Ardian Muka: S'ka problem se dal keq unë, e rëndësishme që të sqarohen qytetarët, se dal keq unë s'ka problem.

Roni Shqiopa : Unë e kam sqaruar kryetaren, këshilltarët, më vjen keq tashi.
E qytetarët të gjithë.

Ani Dymishi: Z. Shqiopa.
O zoti Shqiopa.

Roni Shqiopa : Duke ju sqaruar ju, kam sqaruar dhe qytetarët.

Ardian Muka: Prandaj po them nëqoftëse jam unë difekt nuk ka asgjë, e rëndësishme është që.....

Emiriana Sako: Ta mbaroj njëherë ta mbaroj.

Ani Dymishi: O zoti Shqiopa mos ndërhy.
Mos ndërhy po të them, vetëm kur të jap fjalën unë do flasësh.

Ardian Muka: Atëhere doni pyetje pas pyetje dhe përgjigje apo ti bëj pyetjet e ktheni përgjigje?

Emiriana Sako: Jo mbarojini të gjitha, shtjelloji, pastaj.

Ani Dyrmishi: Bëji njëherë dhe pastaj të kthejnë përgjigje për atë që ti don.

Ardian Muka: Pra, kontributi në sektorin privat në krijimin e fondit publik të banesave. Deri më sot sa e kemi këtë fond? Bashkia e Durrësit ka marrë një fond në sipërfaqe pra në m² apo ka marrë një fond në vlerë leku, në vlerë monetare ?

Emiriana Sako: Për vitin 2024?

Ardian Muka: Për 2024, po.

Atëhere në faqen 17, përsa i takon të ardhurave vendore, tarifa e gjelbërimit pësoi një rritje me 70% krahasuar me vitin 2024 për 2025 dhe tarifa e ndriçimit me 53 % në krahasim me 2024, sepse justifikimi është thënë, se kemi dy tarifat nga takspaguesit familjar duke referuar nga 73292 takspagues regjistruar në systemin e UKD-së krahasuar me 48000 që ka qenë më parë, pra dhe këtu kemi gati 25000 takspagues, të cilët nuk kanë qenë të regjistruar në sistem. Dhe këtu më duket non sens. Si ka mundësi në 2025 kemi 25 000 pa regjistruar në sistem, ndërmjet 2023 dhe 2024 dhe tani planifikojmë një rritje me 70% dhe 53 % për dy taksa për vitin 2025.

Në faqen 18, në masat administrative, të ardhurat e planifikuara nga kundravajtjet dhe gjobat do të rriten me 60% më shumë se viti 2024, masa shtrënguese, Drejtoria e Taksave Vendore, Policia Bashkiake. Nuk më duket e moralshme të planifikohen gjobat duke ditur që, pse tek e fundit duhet planifikuar edhe 60% rritje gjobash. Qytetarët besoj që janë të ndërgjegjshëm natyrisht kush do vëhet gjobë është për tu vënë gjob, por të planifikosh gjobë në rritje me 60% kjo nuk më duket e moralshme në buxhet.

Përsa i takon tek faqa 20, transfetrat e pakushtëzuara sektoriale, menaxhimi i mbetjeve urbane. Fakti 2023 është 236 milion lekë, plani për 2024, 240, plani për 2025, 50 milion lekë me pjesën tjetër. Atëhere pyetja ime është: Në fondin që ne e marrim, fondi i pakushtëzuar që na vjen nga fondet e qeverisë, duke pasur parasysh që në Tiranë nuk ekziston inceneratori, neve sot e kësaj dite, tarifohe mi me 28 apo 29 euro për ton plus tvsh, plus transportin. Dhe transportin me thënë të drejtën e kam me të dëgjuar, sepse në asnjë moment nuk na është bërë publik ku përfshihet, dhe kjo do të jetë ndoshta subjekt i një komisioni që ne kërkojmë edhe hetimor, 10 euro plus 2 euro transport për t'i dërguar në Landfill të Sharrës në Tiranë, paguajmë 46.8 euro ton. Në 2023 mbetjet llogariten rreth 184 ton në ditë, pra janë rreth 3 milion e 143 mijë euro në vit, që nga ana e bashkisë paguhen për djegien e plehrave, ndërkohë që të gjithë jemi koshient që incinatorë nuk ka. Pyetja ime është: Që këto fonde mund të rishikohen? Pra neve si qytet mos të paguajmë 29 euro për ton, të planifikohet dhe incenerimi, por të paguajmë aq sa neve normalisht na takon tek e fundit, meqenëse ne nuk kemi një Landfill. Unë do kisha komplet tjetër zgjidhje ku neve si qytet ta kishim këtu edhe landfillin tonë, të bënim dhe seleksionimin, pra të shkonim drejt seleksionimit, drejt riciklimit dhe jo drejt djegies, por për momentin jemi para faktit. Pra 29 euro për incenerim mund të shihet tarifa, të trajtohet meqenëse nuk ka incenerim nuk ka thjesht një landfill ku bëhet trajtimi i mbetjeve dhe kapsulimi i tyre?

Në faqen 23, kjo ka lidhje me shpenzimet e personelit, po tek menaxhimi i mbetjeve kemi një vlerë për 2025, 427 milion. Kjo ka lidhje me punonjësit e ndërmarrjes së pastrimit të qytetit, besoj

pyetja. Pra përveç vlerës që ne marrim nga qeveria kemi dhe 427 milion që ka lidhje besoj me rrogat e pastrimit të qytetit meqenësë është një fond për 508 punonjës.

Ani Dyrmishi : Ju lutem pak më shpejtë, z. Muka.

Ardian Muka : Dhe një pyetje të fundit në një material të KLSH, është folur që nga bashkia e Durrësit mungojnë 6.3 milion euro nga pjesa e të ardhurave për fondet, të cilat janë të trashëguara nga vitet 2018 dhe këtej. Atëhere meqenëse nuk jemi, unë për vete nuk jam në dijeni të këtij fakti por mediat e kanë bërë publike, mund të na jepni ndonë informacion: Çfarë ka të vërtetë në këtë pikë ? Nëqoftëse është kështu, ku kanë shkur këto fonde? Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit zoti Muka.

Z. Xhelili.

Po, zonja kryetare më fal.

Emiriana Sako: E kam kërkuar unë fjalën.

Tani normalisht mënyra sesi bëhet diskutimi për buxhetin mua personalisht nuk më duket shumë normale, sepse këto janë pjesë e komisioneve dhe ju në komisione mungoni dhe merrni tabelat përpara faqe kaq, faqe aq, ndërkohë unë ftoj të marr gjithë administratën këtu, të marrin të gjithë raportin që kanë dhe t'ju japin përgjigje për të gjitha pyetjet, që bëni të cilat duhet të jenë pjesë e diskutimit të komisionit, pra komisionet pikërisht për këtë arsye bëhen. Vendos administratën në dispozicion dhe t'ju japi qoftë rekordimin e shifrave, qoftë faturat e, tarifën e fjetjes si është llogaritur ku bazohemi çka VKM, çka ligji, qoftë me bilancin e debitorëve dhe ku jemi dhe cilat janë veprimet që ka kryer bashkia për debitorët, qoftë numrin e shkresave që kemi nxjerrë për bllokimin e debitorëve apo drejtuar institucioneve të tjera, të cilët janë në zbatim të ligjit. Dhe mendoj që mund të rrijmë këtë edhe 12 orë edhe më gjatë aq sa të jetë nevoja për t'ju dhënë përgjigje, por nëqoftëse ne kemi komisionin e këshillit dhe ju nuk bëheni pjesë e komisioneve, nuk bëheni pjesë e dëgjësive publike, atëhere nuk mund ta kthjem si një leksion bisedën e Këshillit Bashkiak për të dhënë sqarime me presje me tabela. Jam shumë dakort që ta bëjmë le të vijë e gjithë administrata këtu, të marrin shifrat përpara, të hapin dhe kompjuterat dhe të raportojmë për pyetjet që keni ju në mënyrë të detajuar.

Unë desha të sqaroja mungesën e 6.3 milion ose zhdukjen e 6.3 milion eurove, që është bërë një material mediatik sipërfaqësor mbase dhe i qëllimshëm fare joprofesionist, pra aspak, sepse debitorët kanë dy mënyra sesi raportohen në raportin e KLSH, pra varet nga grupi i KLSH-s që vjen dhe kërkon raportimin, i merr ato progresive ose vjetore dhe në vitin që është bërë raporti në 2023, ky grup i KLSH-së ka kërkuar raportin progresiv të gjithë viteve të mbartur sesi janë reflektuar në bashkinë e Durrësit. Grupi i cili është paraqitur në vitin 2021, që ka bërë raportin e 2018, 2029, 2020, e ka bërë raportimin vjetor dhe progresiv, që do të thotë kështu e ka pranuar dhe kështu e ka kërkuara KLSH dhe kështu e raporton.

Lekët, të cilët janë debitorë që nga vetë fakti që janë debitor janë lekë që s'kanë hyrë kurrë në bashkinë e Durrësit, jo vetëm në bashkinë e Durrësit por të gjitha bashkitë e vendit kanë debitorë në kurriz. Ne e dimë shumë mirë një pjesë prej jush këtu është debitor ndaj bashkisë së Durrësit

dhe përfaqësoni qytetarët dhe mbron të drejtat e qytetarëve edhe fjalën e tyre, sepse ne kemi një kulturë, e cila mungon për pagimin e taksave, që duhet të ndryshoj me kalimin e kohës dhe ne patjetër do bëjmë, do përdorim të gjitha instrumentat që kemi në dorë që na lejon ligji për të bërë veljen e detyrimeve të prapambetura. Dhe vetëm në vitin 2024 kemi nxjerrë 10000 shkresa bllokimi për subjektet, të cilët janë debitorë ndaj bashkisë së Durrësit. Ka dhe instrumenta të tjerë, të cilët janë hapa që do t'i ndjekim në vijim, sepse lihen afate të caktuara me disa subjekte, të cilët kanë pasur debi të larta, por kanë shprehur vullntin që t'i paguajnë kemi bërë marrjveshje të shtrira përgjatë 1 viti, sepse gjithsesi duam që paratë të hyjnë në bashkinë e Durrësit, sepse ne patjetër me këto bëjmë investime dhe do të vijojmë me gjithë hapat përkatës që cakton ligji, qoftë me bllokimin e pronave në ASHK, qoftë me bllokimin e mjeteve në Drejtorinë e Targave dhe me kallzimet përkatëse në Prokurori, të cilën nuk kemi arritur akoma ke ky hap, të cilin patjetër do ta bëjmë, sepse kemi prioritet veljen e tyre. Kështu që ky është një keqinformim, është një lajm fiktiv ku thuhet, që nga buxheti i bashkisë janë zhdukur 6.3 milion euro. Këto lekë nuk kanë hyrë ndonjëherë. Nuk është se kanë hyrë dhe janë shpenzuar apo janë zhdukur apo janë futur nëpër ca thesa të zinj dhe kanë ikur nga bashkia, por janë para, të cilat nuk kanë hyrë asnjëherë falë problematikave që ka pasur, qoftë ndryshimet ligjore, qoftë sektor të caktuar të cilët kanë pasur, me mbylljen e lojërave të fatit po them, të gjithë subjektet që kanë qenë, që kanë punuar në këtë sektor, kanë pasur, kanë qenë, figurojnë sot debitor në bashkinë e Durrësit. Kemi institucione, të cilat janë debitor ndaj bashkisë së Durrësit me të cilat po negocjojmë që të kryerjnë pagesën, sepse në fund të fundit jemi të gjithë për të zbatuar ligjin, qoftë institucionet e tjera vendore, qoftë bashkia e Durrësit për të shlyer detyrimin dhe për të vazhduar punën tonë më tej.

Pastaj për pyetjet e tjera të cilat ...

Ardian Muka: 6.3 thoni ju....

Emiriana Sako: 6.3 është...

Ardian Muka: Ka mossaktësim.

Emiriana Sako: Jo, KLSH ka thënë pasaktësi në raportim, po të lexoni KLSH janë publike të gjithë materialet e KLSH, nuk ka asnjë gjë të fshehtë, shkarkojeni nga faqa që është online dhe aty i lexoni të gjitha, pra pasaktësi e quan pasaktësi raportim, sepse një grup KLSH thotë që duhet raportuar progresiv, një grup tjetër i dy vitesh përpara thotë që edhe raportimi vjetor nuk quhet shkelje. Dhe pas këtij raporti janë hequr këto shifrat jashtë kontekstit normalisht siç ndodh gjithmonë në media dhe janë bërë, është bërë një lajm ku ka marrë dhen dhe kjo është historia. Ne sigurisht që do luftojmë, do vazhdojmë punën me drejtoritë përkatëse që ta ulim sa më shumë këtë debi, por kjo është një fakt me të cilin janë përballë të gjitha bashkitë e Shqipërisë.

Unë mbajta shënim disa nga pikat që ju përmëndët. Në parim paketa fiskale nuk ka asnjë ndryshim, pra në përmbajtje, ka vetëm azhurnimet e bazave ligjore, të cilat janë hedhur të azhurnuara në këtë paketë fiskale, nuk kemi as ndryshime të taksave, as shtim dhe as ulje të tyre, kemi thjesht korigjim për arsye të formës dhe jo të përmbajtjes.

Taksa e ZP është zgjedhur që të bëhet me dy derjtori sepse Drejtoria e Taksave nuk ka inxhinjer, artitekt apo urbanist, që të bëjmë planimetritë. Dhe ajo është një procedurë shumë e thjeshtë, qytetari vjen bën kërkesën nuk ngarkohet me shkëmbimin midis drejtorive po janë verprime që Drejtoria e Shërbimeve i bën me taksat dhe në fund qytetari paguan pagesën përkatëse dhe merr lejen në dorë, domethënë janë veprime të brendshme, të cilat nuk është që ndikojnë apo zgjasin kohën e trajtimit të problematikës.

Sa i takon parkimit me pagesë është e vërtetë që ju e keni çuar në gjykatë, por nuk ka një vendim në sekuestro preventive apo një vendim të formës së prerë, i cili na ndalon ne ta vazhdojmë procedurën. Ju keni mendimin tuaj, e keni çuar në gjykatë, ne do të vazhdojmë edhe në gjykatë do të çojmë përfaqësinë për të mbrojtur, sepse mendojmë që është e domosdoshme për Durrësin sot që të ketë disa zona të caktuara atje ku ka trafikun më të madh, intesistenin më të madh të lëvizjes, disa zona të bëhen me pagesë. Ndryshe nga të gjithë qytetet e tjera Durrësi ka trafik shtunë e të djelë ku të gjithë Tiransit apo qytetarët e tjerë vijnë në Durrës të shijojnë bregdetin shijojnë restorantet dhe kur paguajnë faturat në restorant pse i paguajnë 1 mijë lekë qytetit për parkimin. Në situatën që kemi një lëvizshmëri shumë të lartë sot jo vetëm gjatë sezonit turistik, por edhe jashtë sezonit turistik mendojmë që është një nevojë e jashtëzakonshme e cila është shoqëruar dhe me masa të tjera si ndërtimi i parkimit publik dhe fillimi i punës për dy unazat që mendojmë që do të ketë një efekt shumë pozitiv jo vetëm për turizmin, por do të ketë një efekt shumë të mirë qoftë edhe për zhvillimin e pronës dhe mundësitë që do t'i japi gjithë zonës së Kallmit dhe zonës së Spitallës po themi, atje ku deri ku arrin investimi.

Këto janë pak a shumë ato që doja të thoja, pastaj sigurisht që këtu nëqoftëse doni përgjigje për pyetje specifike, për mënyra specifike: Si janë reflektuar taksat dhe pse? Marim dhe stafin, ulemi këtu flasim dy orë dhe sqarojmë, por normalisht janë diskutime që bëhen në komisionet përkatëse aty sqarohen me detaje.

Ardian Muka: Po për pjesën e mbetjeve?

Emiriana Sako: Pjesa e mbetjeve bashkia ka një kontratë me Landfillin e Sharrës, bashkia e Durrësit nuk paguan incenerimin e mbetjeve. Ka një kontratë me Landfillin e Sharrës dhe nëse keni kohë ju sqaroj dhe praktikën që kemi marrë. Kur kemi shkuar në marrëveshje me Landfillin e Sharrës kemi bërë një analizë e të gjithë tregut, kemi marrë informacion nga Landfilli i Bushatit A ka kapacitet për të pritur Durrësin apo jo dhe sa i ka kostot përkatëse? Kemi marrë nga Landfilli i Vlorës dhe nga të gjithë ato Landfille, të cilat ishin të licensuar për depozitimin e mbetjeve urbane. Dhe patjetër nga ana tjetër ka një masterplan nga menaxhimi i mbetjeve të miratuar në janar të 2020, e cila e ndan Shqipërinë në 10 zona e demarkon në 10 zona për depozitimin e mbetjeve dhe Durrësi së bashku me Tiranën kanë një zonë mbetje. Përpara se të merrnim këtë vendim kemi analizuar territorin në të gjithë hapsirën e ve, për të bërë të mundur a kishim apo jo hapsira dhe kapacitete për ta ndërtuar në qytetin apo qarkun e Durrësit dhe na rezultoi që nuk kishim territore që do të mbulonin këtë shërbim për një kapacitet minimumi 10 vjeçar, sepse e dimë shumë mirë që landfillet nuk ndërtohen për 2 vite apo për 3 vite, por ndërtohen për një kohë të gjatë. Dhe nga ana tjetër kjo është një kontratë koncensionare me Qeverinë Shqiptare, ne kemi kontaktuar kemi lidhur marrëveshje direkt me Landfillin, i cili sot menaxhohet nga shteti, sepse

e dimë që është një asset i sekuestruar dhe 90 % e faturës dhe e buxhetit që ne çojmë për depozitim e mbetjeve mbulohet nga Qeveria Shqiptare. Kostot që thoni ju 10 euro apo 2 euro nuk e di ku i keni lexuar, ato kosto mbulohen nga ndërmarrjet tona. Janë ndërmarrje të shërbimit të cilët nuk kanë marrë para ekstra, por kanë menaxhuar vetëm buxhetin e karburantit kostot, për të shkuar atje, nuk është një distancë e madhe është një distancë vetëm 40 km. Dhe për të thënë të vërtetën Durrësit si për qytetarët e Durrësit është më e mira që të kenë një vend depozitimi një landfill një incenerator sido që të jetë në të ardhmen jashtë qytetit sesa ta ketë brenda qytetit. Kështu që ne kemi parë avantazhet e depozitimit atje. Kemi kontaktën, e cila është aktive me kalimin e viteve kryetarët e tjerë të bashkive që do vijnë mund të kenë planet e veta, do ja lejmë brezave që të gjejnë zgjidhje të tjera në të ardhmen, le të themi.

Ani Dyrmishi: Ok Faleminderit.
Zoti Xhelilaj

Ardian Muka: Një koment më fal, meqenëse unë e kam bërë një kërkesë për të parë këtë kontakt nuk kam arritur ta gjej, i jemi drejtuar edhe Landfillit të Sharrës edhe ato nuk na e kanë dhënë në dispozicion. Në cilësinë e Nënkryetarit i Komisionit të Zhvillimit Urban mund të kem fjalën tuaj të kemi kontratën që ka bashkia e Durrësit dhe Landfilli i Sharrës.

Emiriana Sako: Po s'keni bërë asnjë kërkesë.

Ardian Muka: Urdhëro?

Emiriana Sako: S'keni bërë asnjë kërkesë.

Ardian Muka: Jo po e kërkoj sot, e bëj publikisht pastaj e bëj me shkrim.

Emiriana Sako: Patjetër po, nuk është sekrete.

Ardian Muka: Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Zoti Rolant Xhelilaj

Rolant Xhelilaj: Siç u theksua në fillim miratimi i buxhetit është është shumë i rëndësishëm për Këshillin Bashkiak është i rëndësishëm jo vetëm për personelin e bashkisë, por edhe për qytetarët, sepse përcaktohen rrugët e zhvillimit për vitin 2025 dhe për buxhetin afatmesëm 2025-2027.

Diçka doja të theksoja, por ndërhyrja e kryetares ma hoqi atë mundësi.

Dua të theksoj diçka : Vlerësoj punën serioze të personelit të bashkisë, sepse nga analiza që ju bë projektbuxhetit nga zoti Muka pa komente, është totalisht e drejta e tij ti bëj, më bindi që projektbuxhet i hartuar është cilësor, është i mbështetur në të gjithë bazën ligjore që mbështetet një projektbuxhet dhe përcakton tamam disa drejtime të rëndësishme për zhvillimin e qytetit gjatë vitit 2025 e në vazhdim.

Në kapjen e një analize, të ngjarjeve specifike me shifra me përlogaritje, tregon që projektbuxheti është totalisht korrekt i mbështetur në ligje, i mbështetur në punën e bërë nga bashkia dhe gjithë institucionet që mbulon ajo.

Gjatë vitit 2023-2024 ne shqyrtojmë një buxhet real të vitit 2025 unë dua të theksoj diçka pa u ndalur në ato shifra minimaliste pak me tendencë. Që buxheti i bashkisë për vitin 2025 është në vlerën 5 miliard e 450 milion euro dhe është 21% më i lartë se viti 2024, shifër që trego që është buxhet ambicioz që përcakton intesitet në punën në vazhdim. Dhe ky buxhet në masën 49 % do mbulohet nga taksat dhe tarifat vendore dhe 41 % nga transfertat e buxhetit qendror e pakushtëzuar dhe sektoriale. Dhe ky buxhet ka disa prioritete, për vitin 2025 janë 14 projekte që do të vazhdojnë të menaxhohen nga fondet e bashkisë ku dy që mua më bënë të ndjehem mirë, janë objekte shkollore.

Fondet e dedikuara për këtë proces të rindërtimit për vitin 2025 zënë 62% të buxhetit të investimeve tregon kujdesin e bashkisë por edhe të pushtetit qendror për evidentimin e problemeve që pati Durrësi pas atyre ngjarjeve të trishta. Njëkohësisht vëmëndja nuk le mënjanë edhe infrastrukturën rrugore, arsimin, shërbimet sociale, strehimin, kulturën, rinisë dhe sportit. Gjithashtu dhe shpenzimet për vitin 2025 janë po në të njëjtin masë, po me një rritje 21%. Edhe këtu dua të theksojë që peshën më të lartë e ka zënë shpenzimet kapitale diku të 37 % zënë. Financimi i tyre në masën 57 % do të jenë po nga taksat dhe tarifat vendore dhe 43 % transfertat e buxhetit qendror për financim e komisioneve të bashkisë.

Në projektet e përcaktuara zë peshë, në dëshirën time duhet të vendos në vëmëndje rikonstruksionin e pallatit të kulturës, "Aleksandër Moisiu", një objekt që ka nisur gjatë këtij viti dhe do të përfundoj brenda vitit 2026. Janë dhe plot objekte të tjera siç është përshëmbull ndërtimi i shkollës Met Hasa, ", rikonstruksioni 6 km linear rrugë në njësitë administrative dhe 3.6 në qytet, rikonstruksioni i shkollës "Bajram Curri në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës nga skema e granteve do të alokohen edhe 25 milion lekë dhe nga të cilat 17 milion nga ministria dhe 8 milion nga bashkia.

Në këtë drejtim do të theksoj që projektbuxheti i vitit 2025 përveçse tregon vëmëndjen e bashkisë së Durrësit dhe të Këshillit Bashkiak është në harmoni të plotë edhe me projektbuxhetin afatmesëm me zhvillimet e rëndësishme që ndodhin në rang kombëtar, në të cilat vëmëndja e bashkisë ka qëllim që ti shkojë paralelisht atyre ndryshimeve të mëdhaja që do ndodhin. Dua të theksoj dy, për të mos u zgjatur. Ndryshimet në sistemin e hekurudhës, me vendimin e fundit të kaluar nga Parlamenti, Drejtoria e Hekurudhës do të ndahet në 2 pjesë administrator dhe sipërmarrësi. Administratori që do të merret me investimet në hekurudhë dhe sipërmarrësi për përmirësimin e shërbimeve në transportin hekurudhor. Kjo masë e theksoj dhe zoti Markola në mbledhjen e mëparshme. Kjo shoqërohet dhe me një vëmëndje plus nga bashkia e durrësit për shërbimin e transportit publik, shoqërohet dhe me atë ndërhyrje që bëhet dhe me rikonstruksionin e rrugëve 3,6 km linear rrugë në qytetin e Durrësit.

Dhe në të njëjtën kohë një detyrë e rëndësishme që bashkia i ka vënë vetes në projektbuxhetin e 25-27 është dhe problem i ujërave. Durrësi është një qytet që ka shumë burime ujore, por në të njëjtën kohë është një qytet që ka probleme me eurozonin, ka probleme dhe me trajtimin e hershëm të tyre.

Detyrat këto të vendosura në këtë projektbuxhetin afatmesëm për vitin 2025-2027 tregojnë që puna jonë e nisur deri tani është në rrugën e duhur dhe rezultatet nga viti në vit do të jenë gjithmonë e më të larta.

Në të njëjtën kohë si kryetar grupi, Grupi i Partisë Së Socialiste jep votën pro për buxhetin e vitit 2025 dhe projektbuxhetin afatmesëm për vitin 2025-2027. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Po, zoti Myshketa.

Jonuz Myshketa: Atëhere në lidhje me pikën që ne po trajtojmë, kjo është pika më nevralgjike, buxheti duhet konsideruar jo një buxhet partiak, është buxheti për qytetin e Durrësit. Bashkia me gjithë personelin e saj ka tagrin në menaxhimin sa me efikas të saj.

Nuk mund të them që nuk bie dakort me të gjitha pikat e buxhetit do të ishte një hipokretizim nga ana ime. Po përmend zotin Xhelilaj, të paktën që ka një mendje të shtruar në lidhje me projektin për kulturën siç është rikonstrukcioni i teatrit “Aleksandër Moisiu”. Aty ku unë nuk bie dakort e kam shprehur dhe herë të tjera është pjesa e rëndësës nga buxheti i bashkisë Durrës i fenomenit të rindërtimit do të ishte një proces i mbyllur tashmë. Qeveria për shkak të gjendjes natyrore të gjithë fatëkeqësive, gjendjes së jashtëzakondshme, është ajo që ka tagrat pushteti qendror të menaxhojë dhe të mbyll gjithë atë plagë të hapur të Durrësit pas tërmetit të nëntorit, sepse janë para të munguara nga pjesë e projekteve të shumta që me sfida që ka bashkia, dhe të cilat përkthehen në shërbime dhe investime për qytetarët e Durrësit.

Prandaj unë e shoh pak, duke pasur parasysh që u ngrit një Ministri përkatëse dhe u trumpetua me të madhe vjelja e 1 miliardë euro, por deri tashi duhet të kishte mbaruar ajo pjesë.

Dua të ndalem, kjo është një nga pikat që mua më bën të pamundurën ta votoj pro, thashë nuk jam dakort jo se nuk jam dakort me të gjitha pikat, por një pjesë tjetër do ndalem dhe tek tema e mbetjeve, por me të vërtetë që bashkia ka një kontratë me Landfillin e Sharrës nuk incenerohen mbetjet i referohem vetëm raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit i referohem vetëm asaj, sepse shoh që pjesa e mbetjeve është pjesë e rëndësishme në buxhetin e Bashkisë Durrës dhe zë një pjesë të shpenzimeve. Dua të merren masa sepse në Kontrollin e Lartë të Shtetit në raportin e tij thuhet se :“Bashkia në kontratën që ka me Landfillin e Sharrës i paguan sipas KESH-it apo jo në mos gabohem?

Emiriana Sako: Po

Jonuz Myshketa: Dhe në Kontrollin e Lartë në këtë raport thuhej se nuk ka një peson përgjegjës dhe nuk ka një monitorim të qartë të peshës që shkon tek pika tjetër.

Emiriana Sako: S’është e vërtetë.

Jonuz Myshketa: Nuk do doja që të abuzoj me taksën e qytetarëve dhe pse bashkisë të mbushin xhepat për shkak të një moseficientë ose nuk di si ta quaj këtë pjesën e munguar, gjithmonë sipas raportit, se nuk e shohim dhe nuk ka një monitorim të qartë të tyre.

Për pjesën tjetër buxheti, po dhe kryetarja e tha, nuk mund të merren të gjitha pikat zë për zë plus, sepse do të ishte goxha e lodhshme qoftë për qytetarët që na ndjekin, por atë që dua të them është që i qëndrojmë në koherencë me kësaj pjese që buxheti nuk është personal, buxheti është i të gjithëve ne dhe ne si qytetarë jemi këtu për të arritur në një performancë të mirë të bashkisë, qoftë kjo e majtë e djathtë e kuqe, blu, rozë e të tjera e të tjera, por pa cinizma dhe pa mbetje qefi i dikut po mos ti marrim gjërat personale po këtu kemi një detyrë përsipër është përfaqësues i qytetarëve dhe ka përgjegjësi qoftë morale, qoftë politike dhe mbi të gjitha dhe penale, dhe këto ishin pikat që unë do prek, pa dashur t'ju lodh me shumë detaje. Pra dhe një herë përsëritje kam këtë pikëpyetje edhe të mbetjeve: Pse nuk peshohen mirë? Dhe procesi i rindërtimit duhet të ishte mbyllur tashmë kjo plagë e hapur dhe duhet të monitorohet nga qeveria dhe jo të rëndohen në xhepat e Bashkisë Durrës dhe qytetarëve tanë. Faleminderit.

Emiriana Sako: Mirë, faleminderit për ndërhyrjen.

Ne normalisht edhe këtë vit figuron programi i rindërtimit sepse financimet e vitit të vjetshëm kanë qenë dy vjeçare dhe kontratat kanë filluar dhe sigurisht që puna më e madhe është ndarë specifikisht në vitin 2024, 2025 dhe ato do të reflektohen gjatë gjithë vitit 2025, sepse kanë qenë me dy vite financim dhe normalisht transmetohen dhe tani. Këtë vit ne kemi futur si investim të rëndësishëm të ri në programin e rindërtimit, rindërtimin e pallatit Ushina, dhe ky është një lajm i mirë që dua tja jap banorëve të lagjes 5, sepse ka qenë një kërkesë e hershme e tyre që objektet, objekti të rindërtohej atje, por duke qenë se ne kemi bërë gjithmonë analizën e apartamenteve në lagjen e re të rindërtimit na rezultoi që atje numrat janë duke shkuar drejt fundit le të themi, pra duke u zënë të gjitha apartamentet dhe kemi mundësi që me ndërtimin e këtij objekti të akomodojmë banorët e këtij pallati dhe që e kanë pasur këtë kërkesë të vazhdueshme për rindërtimin në të njëjtin vend.

Brenda këtij viti lidhim dhe kontaktin për shkollën e Vadardhës, edhe ky një objekt, i cili është prishur nga dëmet që pësoi nga tërmeti, për t'i hapur rrugë kantierit atje. Ky është një, ka qenë buxheti në vitin 2024 morën kohë procedurat e tenderimit, por edhe pjesa e spostimit të shkollës sepse vendosëm ne duke dëgjuar komunitetin që ta spostonim në zonën ku kanë qenë pallatet e reja, ku kanë qenë pallatet që u prishën dhe këto vendime bëjnë që kontrata të lidhet tani dhe të ekzekutohet dhe kjo kontratë në vitin 2025. Ne do ta vazhdojmë programin e rindërtimit derisa të përfundojë, sigurisht që duam që sa më shpejtë të akomodojmë familjet në lagjen e re të Spitallës, sepse ajo do të mbyll një kapitull shumë të rëndësishëm janë rreth 1000 familje, të cilat do të akomodohen atje, janë duke u bërë përfundimet e fundit, investime të vogla në lidhje me rrjetin me OSHE dhe disa investime në kanalizimin e rrjetit të ujërave të zeza. Me përfundimin e tyre do të bëjmë akomodimin dhe mund të themi që kemi vënë një gurë në kapitullin e rindërtimit, por ka ende objekte që për arsye të problematikave teknike dhe kompleksitetit teknik që kanë pasur rastet do të vazhdojnë dhe në të ardhmen por kjo s'është thotë që programi nuk ka mbaruar në pjesën më të madhe të tij, sepse nëqoftëse do të bëjmë një bilanc kemi mbi 500 familje të cilët jetojnë në shtëpi të reja dhe në apartamente sot. Dhe pjesa tjetër është drejt fundit, pallati te Dalip Peza është përfunduar dhe ai dhe aty do të bëjmë akomodimin e familjeve shumë shpejt, Lura, Dakli familjarët kanë marrë çelësat dhe kështu me radhë që mos të zgjatemi ky program është dhe në buxhetin 2025 pikërisht për këto arsye.

Sa i takon peshimit të mbetjeve është çështje shumë shumë e rëndësishme për ne, KLSH-ja bën konstatimet e veta, por ne kemi bërë oponenca dhe për këto kontatime. Të gjitha mjetet sa herë shkojnë atje mbetjet peshohen, fotografohet mjeti, fotografohet targa dhe këto janë materiale që shoqërohen çdo institucion i cili kalon, pra ne kemi caktuar dhe një person. Patjetër që janë grupet e punës pra mbikqyrësit e kontratave, të cilët janë duke çuar për ndërmarrjen e plazhit dhe për ndërmarrjen e Durrësit, pra ndërmarrja e Durrësit ka grupin e vet të monitorimit të kësaj kontrate në momentin që depozitojnë ndërmarrja e Plazhit ka grupin e vet në Landfillin e Sharrës. Kemi vendosur dhe një person pikë kontakti për bashkinë së Durrësit një person, i cili është aty si një dispeçer ose si një mbikqyrës, i cili është prezent për të parë mjetet e bashkisë dhe për të parë edhe procesin e peshimit. Pra që mos të ishte vetëm në dorë të personave që shkonin bashkë me mjetin, por të kishin një person përgjegjës. Normalisht vendosja e peshores, ne kemi parë dhe vlerësimin e blerjes së një peshoreje dhe vendosjes së peshores në një zonë të qytetit, por këtë vendim do ta marrim, duke qenë se Sharra e ka peshoren nuk e kemi bërë këtë investim, sepse është atje do të ishte e njëjta gjë dhe këtu. Kemi parashikuar që në ngritjen dhe strukturimin e stacionit të transferimit, i cili është një element shumë i rëndësishëm për të ulur kostot për të bërë fillimin e procesit të diferencimit, të plastikës, të qelqit të futjes së tyre në treg pra të shitjes tek të tretët do të bëjmë dhe do të bëjmë edhe mundësinë e peshimit edhe në Durrës edhe përpara se të depozitohet në Landfillin e Sharrës. Dhe ky është një proces të cilin e kemi filluar me KfV-në, jemi duke bërë me ta, pra ka një grant nëpërmjet Qeverisë Shqiptare, Durrësi është një nga bashkitë përfituese, kanë bërë draftet e pozicionimit të stacionit të transferimit ata, por besojmë se 2025 do të jetë një vit, i cili do të marrim vendim të rëndësishëm sa i takon menaxhimit të mbetjeve urbane dhe të uljeve të kostove që dhe për bashkinë është shumë e rëndësishme që të minimizojmë dhe të futemi në ato bashkitë, të cilat dhe të huaja pse jo, pra të krahasohemi me qytetet jashtë dhe që të kemi konceptin e diferencimit dhe riciklimit të mbetjeve të qytetit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit kryetare.

Komente tjera? S'ka më.

Atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit të pikës 4.

Kush është Pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?.....8

Me 29 pro, 8 abstenim miratohet pika 4 e rendit të ditës.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** zoti Myshketa.

Jonuz Myshketa: Kohët e fundit është hapur tema e mbetjeve megjithëse është një temë shumë sensibil për qytetin, doja të dija fatin e depozitimit të mbetjeve toksike që ndodhen në zonën e Porto Romanos, me nga 103 kontenier, më korigjoni nëqoftëse nuk jam i saktë, në të cilat u bënë kohë që janë depozituar aty me kërkesë të Prokurorisë. Po dakort po monitorohen aty, por e ngrej këtë sepse hetimet e shumta të qytetarëve, të cilët janë shqetësuar në lidhje me afërsinë në të cilën ndodhen banesat e tyre dhe çfarë do bëhet pra? Unë e kuptoj që nuk është faji i bashkisë, por bashkia monitoron territorin dhe për këtë është përgjegjëse. Keni një përgjigje në lidhje me ?

Emiriana Sako: Nuk kemi kompetenca për këtë. Është çështje në hetim nuk kemi kompetenca.

Jonuz Myshketa: Është çështje në hetim nuk keni asnjëloj kompetence në lidhje me këtë dhe siguria maksimale. I keni marrë masat e sigurisë maksimale aty, besoj që ti qetësojmë qytetarët?

Emiriana Sako: Është detyrë e Prokurorisë.

Jonuz Myshketa: Është detyrë e Prokurorisë, sigurisht mirë. Kjo ishte pyetja që kisha unë, me një përgjigje shteruese. Faleminderit.

Emiriana Sako: Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit zoti Myshketa.
Gëzuar fetstat dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Emiriana Sako: Gëzuar!....

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 26 (njëzet e gjashtë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë DIU:

FLORIAN TAHIRI